

V E N D I M
Nr.564, datë 7.8.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA REHABILITIMI I URËS SË BËNÇËS, TEPELENË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarit, i cili preket nga rehabilitimi i Urës së Bënçës, Tepelenë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 866 m² tokë/truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 732 000 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë) lekësh.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 5. Fondet prej 1 732 000 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë) lekësh, për shpronësimin e pronarëve dhe prej 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekësh, për shpenzimet procedurale, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2003.
 7. Afati i përfundimit të ndërtimeve për rehabilitimin e kësaj ure, që kanë filluar në qershor 2003, të jetë brenda muajit shtator të po këtij viti.
 8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REHABILITIMI I URËS SË BËNÇËS,
TEPELENË**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr/pasurisë	Truall		Vlera lekë	Shënime
					Sip. e shpronësuar	Çmimi lekë/m ²		
1	Agron	Ramadan	Hasa	3,47	866	2000	1732000	

Mbyllet me numër rendor 1 (një)
Vlera e shpenzimeve procedurale 65 000 lekë

Vlera totale e shpronësimit 1 797 000 lekë